



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E SHTIMES
MUNICIPALITY OF SHTIME/ OPSTINA STIMLJE

ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

/KANCELARIJA PRESEDNIKA OPSTINE/MAYOR'S OFFICE

ZYRA PËR INFORMIM/ INFORMATION OFFICE/ KANCELARIJA ZA
INFORMISANJE

Data/Datum/Date:	30.6.2025
Nr./Br./No	02/697
Për/Za/To:	Kuvendin e Komunës së Shtimes-kryesuesi Adnan Ademi
Përmes/Preko/Through:	z. Qemajl Aliu, kryetar i Komunës së Shtimes
Nga/Od/From:	Vlora Hyseni, kordinatore e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi
Lënda/Predmet/Subject:	Informatë për punën e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për gjashtëmujorin Janar-Qershor 2025

Në periudhën raportuese Janar-Qershor 2025, Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) ka mbajtur tri mbledhje të rregullta dhe dy jashtëzakonshme, me pjesëmarrjen aktive të të gjitha institucioneve relevante, përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, Drejtorive Komunale, shërbimeve emergjente, arsimit, shëndetësisë, shoqërisë civile.

Raporti është bazuar në Strategjinë dhe Planin e Veprimit si dhe Planit Vjetor të Punës dhe përmbledh temat kryesore të trajtuara në tri mbledhjet e rregullta dhe dy mbledhjet e jashtëzakonshme të mbajtura gjatë këtij gjashtëmujori.

Të gjitha këto mbledhje janë udhëhequr nga Nënkryetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa.

Me vendim të Kryetarit të Komunës së Shtimes z. Qemajl Aliut për themelimin e KKSB në Shtime me nr:prot 02/40 dt: 23.01.2025 më dt: 24.01.2025 është caktuar mbledhja e jashtëzakonshme e KKSB, që kishte këtë pikë të rendit të ditës:

Shqyrtimi i situatës së krijuar pas dhunës së shkaktuar nga S.S

Kjo mbledhje e jashtëzakonshme u thirr në kohë të shkurtër, si reagim institucional ndaj rasteve të dhunës së shkaktuar nga një nxënës i shkollës, S.S., rast që kishte shqetësuar nxënësit dhe qytetarët e komunës sonë dhe kishte ngritur nevojën për masa të menjëhershme parandaluese dhe trajtuese.

Gjatë kësaj mbledhje u prezantua situata e detajuar e rastit, si dhe ndikimi i tij në ambientin shkollor gjithashtu u kërkuar mobilizim maksimal nga institucionet arsimore, sociale dhe të rendit për monitorimin e situatës. U vendos që të monitorohen dhe trajtohen me kujdes rastet e sjelljeve nga ana e nxënësve S.S. dhe A.J., me fokus të veçantë në mbrojtjen e të nxënësve, sigurinë në shkolla dhe ruajtjen e ambientit edukativ.

Po ashtu gjatë kësaj mbledhje u nxor edhe një konkluzion për trajtimin dhe monitorimin e sjelljeve të nxënësit S.S dhe A.J.

Mbledhja e parë e KKSB-së, është mbajtur më 10 mars 2025, dhe kishte këtë rend dite:

- 1.Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 23.12 2024;**
- 2.Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;**
- 3.Përfshirja e qytetarëve në procesin e reduktimit të dhunës dhe varësisë nga droga-organizimi i tribunave për edukim dhe për rëndësinë e raportimit;**
- 4.Të ndryshme**

Mbledhja u hap me konstatimin e listës së anëtarëve të pranishëm. U sigurua kuorumi i nevojshëm për vazhdimin e punës dhe mbledhja vijoi sipas rendit të ditës.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 23 dhjetor 2024, u shqyrtua dhe u hodh në votim. Anëtarët e KKSB-së e miratuan pa asnjë vërejtje.

Komandanti i Stacionit Policor të Shtimes, Haxhi Behluli, prezantoi një analizë të detajuar të gjendjes së sigurisë në komunë, duke evidentuar, sfidat me të cilat janë përballur forcat e rendit, statistikatat e incidenteve dhe problematikave të identifikuara.

Rëndësinë e bashkëpunimit mes Policisë, institucioneve lokale dhe qytetarëve për garantimin e sigurisë publike. Një fokus i veçantë iu kushtua diskutimit për përfshirjen e qytetarëve, prindërve, mësimdhënësve dhe organizatave të shoqërisë civile në procesin e parandalimit të dhunës dhe varësisë nga droga, përmes, organizimit të tribunave publike edukative. Fushatave ndërgjegjëse për rëndësinë e raportimit të rasteve problematike.

Mbledhja e dytë e KKSBB-së, është mbajtur më 5 maj 2025, dhe kishte këtë rend dite:

- 1.Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 10.3.2025;**
- 2.Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;**
- 3.Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);**
- 4.Të ndryshme**

Mbledhja u hap nga nënkryetari i Komunës së Shtimes, Faruk Beqa. Ai prezantoi rendin e ditës dhe udhëhoqi shqyrtimin e procesverbalit të mbledhjes së mëparshme të mbajtur më 10 mars 2025.

Procesverbali u shqyrtua dhe u aprovua pa komente të tjera nga anëtarët e pranishëm.

Komandanti i Policisë, Haxhi Behluli, prezantoi gjendjen aktuale të sigurisë në komunë, duke theksuar nevojën për rritje të angazhimit të qytetarëve në raportimin e rasteve të dyshimta. Identifikimin e zonave që paraqesin sfida më të theksuara për sigurinë.

Ndërsa për pikën e dytë, për shkak të mungesës së zyrtarit përgjegjës për sigurinë ushqimore, diskutimi mbi këtë temë u shty për mbledhjen e ardhshme, ndërkohë që nga anëtarët u kërkuar organizimi i inspektimeve të rregullta dhe ngritja e kapaciteteve për kontrollin e cilësisë së produkteve ushqimore në treg.

Në pikën, të ndryshme, u trajtuan çështje të tjera me interes publik, përfshirë problematikat e shqetësimet e qytetarëve dhe nevojën për përforsimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Me 22 maj 2025. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajti edhe një mbledhje të jashtzakonshme, ku pikë të rendit të ditës pati:

- 1.Shqyrtimi i situatës së krijuar për rastin e SH.LL.**

Kjo mbledhje u organizua për të trajtuar një situatë të ndjeshme, që kishte të bënte me personin SH.LL. , rasti i të cilit kishte krijuar shqetësim te qytetarët dhe kishte nevojë për trajtim të kujdesshëm institucional.

Gjatë kësaj mbledhje u prezantuan detaje mbi rrethanat e rastit dhe ndikimi i tij në sigurinë dhe stabilitetin.

Të pranishmit theksuan urgjencën e trajtimit të personit në fjalë nga institucionet përkatëse, duke respektuar të drejtat dhe dinjitetin e individit, por njëkohësisht duke marrë masa të domosdoshme për ruajtjen e rendit publik. Mbledhja u mbyll me miratimin e një rekomandimi, i cili iu adresua institucioneve kompetente me kërkesën për veprim të shpejtë dhe efektiv.

Më 20 qershor 2025, është mbajtur mbledhja e tretë e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), ku u diskutuan çështje të ndryshme të rëndësishme për komunën e Shtimes.

Mbledhja u zhvillua sipas rendit të ditës si vijon:

- 1.Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 5.5.2025;**
- 2.Informatë për çështje të sigurisë në Komunën e Shtimes nga Policia e Kosovës;**
- 3.Siguria ushqimore (kontrolli i cilësisë, kushteve dhe shpërndarjes së produkteve ushqimore);**
- 4.Informatë nga Njësia Profesionale për Zjarrëfikje dhe Shpëtim në Shtime;**
- 5.Informatë nga drejtorja e Arsimit;**
- 6.Të ndryshme**

Anëtarët e KKSB-së shqyrtuan dhe aprovuan procesverbalin e mbledhjes së kaluar.

Nexhmedin Ahmeti, përfaqësues i Policisë së Kosovës, prezantoi gjendjen e sigurisë në komunë, duke përfshirë, statistikën mbi incidentet e raportuara, përpjekjet për rritjen e sigurisë në hapësirat publike, rëndësinë e bashkëpunimit me qytetarë në adresimin e sfidave të sigurisë.

Komandanti i Njesisë së Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, Bajram Gashi, paraqiti planin e masave për sezonin e verës, me theks në, parandalimin e zjarreve në hapësirat publike dhe pronat private, rritjen e gatishmërisë së njesisë për ndërhyrje të shpejta në rast emergjencash, bashkëpunimin me qytetarë dhe institucione.

Shefi i Zyrës së Arsimit, Lulzim Sahiti, prezantoi një raport gjithëpërfshirës mbi arritjet dhe sfidat në sektorin e arsimit, për periudhën janar-qershor 2025, duke nënvizuar, investimet në infrastrukturën arsimore, masat për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, kontributin e arsimit në parandalimin e dukurive negative si dhuna dhe devijimi social.

Sfidat dhe Shqetësimet

Bazuar në punën e deritanishme të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB) në Komunën e Shtëmës, mund të konstatohet qartë se bashkëpunimi ndërinstitutional, përfshirja aktive dhe qasja e koordinuar kanë dhënë rezultate të prekshme në përmirësimin e gjendjes së sigurisë dhe në trajtimin e sfidave që prekin mirëqenien e qytetarëve.

Të gjitha mbledhjet e KKSBB-së janë karakterizuar nga diskutime konstruktive, transparencë dhe pjesëmarrje aktive të anëtarëve.

Është një frymë e mirë e bashkëpunimit mes Policisë së Kosovës, Drejtorive Komunale, shërbimeve emergjente dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm.